

AKT NORMATIV
Nr.1, datë 11.9.2005

**PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË
FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE), LIDHUR ME DISPOZITAT E
MBËSHTETJES SË VENDIT PRITËS PËR FORCAT PJESËMARRËSE PËR STËRVITJEN
“COOPERATIVE ENGAGEMENT 05” DHE ZHVILLIMIN E STËRVITJES USHTARAKE
NDËRKOMBËTARE TË DREJTUAR NGA NATO “COOPERATIVE ENGAGEMENT 05”,
ME PJESËMARRJEN E FORCAVE TË HUAJA USHTARAKE NË TERRITORIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (ShAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse për stërvitjen “Cooperative Engagement 05” dhe zhvillimin e stërvitjes ushtarake ndërkombëtare të drejtuar nga NATO, “Cooperative Engagement 05”, me pjesëmarrjen e forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Modalitetet e zhvillimit të stërvitjes dhe statusi i forcave të huaja ushtarake pjesëmarrëse në këtë stërvitje ndërkombëtare do të jenë ato të përcaktuara në memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse për stërvitjen “Cooperative Engagement 05”, marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, lidhur me statusin e forcave, nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951, të ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995 dhe marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre.

Neni 3

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha